



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE  
DREJTORIA E SHËRBIMIT PËR TATIMPAGUESIT  
Sektori i Asistencës dhe Shërbimit

Nr. 40763 Prot.

Tiranë, më 16 / 12 2016

Lënda: **Kthim përgjigje**

Drejtuar: **Z. Saimir KODRA**  
**Drejtor i programit "STOP", Televizioni KLAN**  
**Rr."Aleksandër MOISIU", Nr.97**

**TIRANË**

**I nderuar z.Kodra,**

Në cilësinë e kërkesit, keni depozituar në formë shkresore, kërkesën për dhënie informacioni, regjistruar në regjistrin e kërkesave me numër rendor 13 datë 16.12.2016, bazuar në Ligjin nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit, si dhe protokolluar në DPT nr.40763 Prot, datë 13.12.2016, në lidhje me pagesën e taksës së pastrimit si biznes i madh për subjektin "JOER" me NIPT J72217004F.

Pas shqyrtimit të kërkesës, e cila ishte në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", ju sqarojmë si më poshtë vijon:

Lidhur me ankesën në lidhje me pagesën e taksës vendore, sqarojmë se kjo taksë administrohet nga pushteti vendor.

Subjekti është regjistruar me përgjegjësinë tatimore të Tatimit mbi Fitimit në datën 17.10.1997 dhe ka paraqitur rregullisht deklaratat vjetore të Tatimit mbi Fitimi.

Theksojmë se, në Ligjin Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, në nenin 16 "Fusha e veprimit të tatimit mbi të ardhurat", pika 2, përcaktohet: "*Çdo person, sipas kuptimit të këtij ligji, pavarësisht nga statusi ose forma ligjore e regjistrimit apo e njohjes së tij, kur është a bëhet subjekt i tatimit mbi fitimin, ka të drejtë të kërkojë çregjistrimin në çdo kohë, por jo të kalojë si subjekt, që i nën shtrohet tatimit të thjeshtuar mbi fitimin mbi biznesin e vogël.*"

Bazuar në referencën ligjore sa më sipër, duke sqaruar se Organi Tatimor është organ ligjzbatues, ky tatimpagues nuk mund të ndryshojë përgjegjësinë tatimore nga Tatimi mbi Fitimin (Biznes i madh) në Tatim të Thjeshtuar mbi Fitimin (Biznes i vogël).

Ju falenderojmë për mirëkuptimin,

**ZV/DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**XHAVIT ÇURRI**